



A.nr.347/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.347/2026, të datës 25.03.2026, të parashtruar nga ankuesja SH.B, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokate Kaqusha Avdiu-Sylejmani, nga Gjilani, kundër organit të punësimit: Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur 17.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.347/2026, e datës 25.03.2026, e parashtruar nga ankuesja SH.B, ashtu që, **anulohet** çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe vlerësimit profesional, ndërsa, procedura e pranimit me numër reference RN00019130, për pozitën e punës Udhëheqës i zyrës regjionale, Gjilan, kthehet në fazën e verifikimit të aplikacioneve.

II. Obligohet Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit, si dhe në rivlerësim të aplikacioneve të veproj në pajtim të plotë me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, SH.B (*tutje referuar: ankuesja*), me datë 25.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Akt-Njoftimit Nr. 177/2026, të datës 29.01.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë

Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, përmes të cilit i është refuzuar aplikacioni për procedurën e pranimit me numër reference RN00019130, të shpallur më datë 16.12.2025, nga Agjencia Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronë, për pozitën e punës *Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Gjilan*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronë, ndërsa, kjo e fundit ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar: Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1511/2026 të datës 25.03.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; ID identifikuese të personit të autorizuar për përfaqësim; Autorizimin e datës 12.03.2026; ID identifikuese të ankueses;

Konkursin me numër të referencës RN00019130; Njoftimin me numër 177/2026 i datës 29.01.2026; Akt emërimi i datës 06.01.2025 i ankueses; Vendimin për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit; Ndryshimi dhe Plotësimi i aktit të emërimit i datës 03.08.2015; Akt emërimi i datës 21.12.2011 i ankueses; Diploma me numër 28/0112 i datës 24.01.2012; Shkresa e datës 04.03.2026 e përfaqësueses së NARIC; Përgjigje në ankesë e datës 22.04.2026; Vendimin për themelimin e komisionit të pranimit i datës 10.02.2026; Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të pranimit; Listën e kandidateve që kanë aplikuar; listën e kandidateve që kanë kaluar verifikimin paraprak; Njoftimi për kandidate që i plotësojnë kushtet e konkursit 29.01.2026; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për interviste; Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 27.02.2026; Njoftimi për renditjen përfundimtare/kandidatin fitues i datës 27.02.2026; Aplikacionin e kandidatit fitues; Aplikacionin e ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit ka gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara, sepse:

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

- Agjencia Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronë, më datë 16.12.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00019130, për pozitën e punës *Udhëheqës i Zyrës Regjionale*, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, i hapur për aplikim nga data 17.12.2025 deri më datë 15.01.2026.

-Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 29 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa, prej tyre 12 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke mos përfshirë këtu ankuesen, të cilës sipas Njoftimit Nr. 177/2026 të datës 29.01.2026, të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, rezulton se i është refuzuar aplikacioni për arsye se, citoj:....*Pas verifikimit të të gjitha dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacionin e kandidates është konstatuar se kandidatja në aplikimin e saj nuk ka të bashkëngjitur*

dëshmitë lidhur me shkollimin adekuat për këtë pozitë gjegjësisht nuk ka të bashkëngjitur dëshminë lidhur me kualifikimin arsimor sipas kërkesës së konkursit: *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (bachelor). Drejtimi: Drejtimi Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencat Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike. Kandidatja ka bashkëngjitur diplomën e nivelit Bachelor i Arteve në Menaxhment.*

- Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, pas përfundimit të procedurës përkatëse të rekrutimit, më datë 27.02.2026, ka publikuar Njoftimin me numër 233/26, nga i cili akt rezulton se kandidati A.L me gjithsej 95 pikë, është shpallur kandidat fitues për pozitën e punës *Udhëheqës i zyrës regjionale, Gjilan.*

II. Pretendimet e ankueses

Ankuesja kundërshton vendimin Nr. Nr. 177/2026 të datës 29.01.2026, të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, për refuzimin e aplikacionit, me pretendimet ankimore se në aplikacionin e saj ka bashkëngjitur Diplomën me numër 28/0112 të datës 24.01.2012, më të cilën ka marr titullin: Bachelor i Arteve në Menaxhment, ku organi i punësimit ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike duke refuzuar aplikacionin sepse e njëjta ka dorëzuar Diplomën me numër 28/0112 të datës 24.01.2012 dhe mori titullin Bachelor i Arteve në Menaxhment me të cilin dëshmon se ka përfunduar studimet bachelor. Kërkon që të anulohet konkursi me nr. te referencës RN000019130.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore fillimisht ka analizuar shpalljen e Konkursit publik me numër reference RN000019130, nga dhe konstatoi së për pozitën *Udhëheqës i zyrës regjionale, Gjilan* i kritere formale janë shpallur: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (bachelor). Drejtimi Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkencat Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike. Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa, në kuptim të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë:

- Nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos*

ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj;

-Nenit 39, ku përcaktohet se: *Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.*

2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NJMBNJ-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NJMBNJ e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNJ-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. 12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.

Kolegji i Këshillit, po ashtu ju referua Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, respektivisht:

-Nenit 7 paragrafi 1, ku përcaktohet: 1. *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

-Nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. *Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit.* 2. *Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimi përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara, për faktin se e njëjta me rastin e aplikimit në konkursin përkatës ka deponuar si dëshmi Diplomën me numër 28/0112, të datës 24.01.2012, të lëshuar nga Kolegji Fama, me të cilën dëshmohet se e njëjta me datë 21.11.2011, ka

mbaruar studimet në Kolegjin “Fama” duke fituar titullin: Baçelor i Arteve në Menaxhment, ndërsa ndërlihdur më kriterin e përvojës së punës posedon dëshmi aktin e emërimit të datës 23.12.211 për emërim në pozitën Zyrtare Regjionale në Zyrën Regjionale në Gjilan, Agjencia Kosovare e Pronës, tani Agjencia Kosovare për Verifikim të Pronës, ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 02.08.2015, për emërimin në pozitën u.d.Zëvendës, Drejtor ekzekutiv dhe akt emërtimi nr.00108/2025, të datës 06.01.2025, për sistemim në pozitën Zyrtare regjionale për zbatim të vendimeve, Zyra Regjionale Gjilan.

Ne fakt, në vlerësimin e Kolegjit Njësia përgjegjëse e AKVP-së ka dështuar në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në raport me refuzimin e aplikacionit të ankueses, për faktin së kjo njësi paraprakisht do të duhej të kërkonte sqarim nga Agjencia e Akreditim të Republikës së Kosovës lidhur me fushën e studimeve të ankueses për vërtetim të faktit nëse fusha e studimeve të ankueses përmbushë kriterin e fushës së ekonomikut. Në mungesë këtij veprimi të institucionit gjegjes, vetë pala ankuese ka kërkuar sqarim nga Divizioni për Njohje dhe Informim Akademik-NARIC, kështu që ku i fundit në përgjigjen më dhënë sipas shkresës më numër protokolli 11/3-602, të datës 04.03.2026, përgjigjet citojmë: *...Institucioni në të cilën ju keni ndjekur studimet ka ushtruar veprimtarinë në bazë të licencës së lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) për tre (3) departamente: Ekonomik, Juridik dhe Shkenca Politike. ...Bazuar në dokumentacionin që kemi në dispozicion, në atë periudhë kolegji “Fama” ka pasur të licencuara vetëm këto tri departamente, përfshirë edhe departamentin ekonomik. Në praktikën e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, programet e fushës së menaxhmenit zakonisht organizohen në kuadër të fakultetit ekonomik. Kjo reflektohet edhe në Universitetin e Prishtinës -si universiteti i parë dhe më i madh publik në vend- programet e fushës ekonomike, përfshirë Bankë dhe Financë Menaxhment, Marketing, Ekonomiks dhe Kontabilitet, janë të organizuara në kuader të Fakultetit Ekonomik. Poashtu, një qasje e ngjashme ndiqet edhe nga universitetet e tjera publike (p.sh. Universiteti public “Ukshin Hoti” Universiteti “Kadri Zeka” etj.) si dhe nga institucionet private të arsimit të lartë, ku programet e menaxhimit mund të jenë të strukturuar në mënyra të ndryshme, por në thelb mbeten të lidhura në fushën/ fakultetin ose departamentin ekonomik. Për rrjedhojë, diploma e juaj e fituar para fillimit të zbatimit të procesit formal të akreditimit konsiderohet e vlefshme dhe mbajtësit e tyre gëzojnë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga një kualifikim i tillë, përfshirë vazhdimin e studimeve të mëtejme si dhe mundësitë profesionale për të cilat kërkohet posedimi i një diplome të nivelit përkatës.*

Andaj, mbi bazën e fakteve si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin së Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses i ka mohuar të njëjtës të drejtën e pjesëmarrjes në procedurën përkatëse të konkurrimit dhe duke i pamundësuar vazhdimin në fazën e vlerësimit, veprime këto në kundërshtim më nenin 39 paragrafi 7 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, endja, edhe Akt-njoftimi Nr. 177/2026, i datës 29.01.2026, i Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke qenë së shkeljet materiale i referohen fazës së verifikimit paraprak, atëherë çdo veprim tjetër i pasuar pas kësaj fazë konsiderohet veprim pa pasoja juridike dhe si të tilla nuk i nënshtrohet vlerësimit

të ligjshmërisë, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, vendosi që të anulohet të gjitha veprimet administrative në fazën e verifikimit paraprak dhe vlerësimit profesional, për konkursin me numër reference RN00019130, me detyrimin që Divizioni i Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës të marrë parasysh të gjeturat dhe pikëpamjet juridike sipas këtij vendimi, përkatësisht procedura sipas konkursit përkatës, duhet të vazhdojë në fazën e verifikimit të aplikacioneve për të gjithë kandidatët duke përfshirë këtu edhe ankuesen, dhe e njëjta të zhvillohet në pajtueshmëri të plotë me dispozitat ligjore.

KËSHILLË JURIDIKE: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.347/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësues së autorizuar të ankueses Avokate Kaqusha Avdiu-Sylejmani;
- Divizionit për Burime Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.